

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e  
Legjislacionit Mjedisor**

*Një projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian*

**Projekt Urdhër  
për Formatin e raporteve për lejet e mjedisit të Tipit A në zbatim të  
Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”<sup>1</sup>**

**Draft Final**

**25.05.2011**

---

<sup>1</sup> Ky urdhër transponon Vendimin e Komisionit 2006/194/EC Hartimi i pyetësorit në lidhje me Direktivën 96/61/EC përsa i përket parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRI I MJEDISIT PYJEVE  
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

**URDHËR I BRËNDSHËM**

**(Draft Final 25.05.2011)**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**Formatin e raporteve për lejet e mjedisit të Tipit A në zbatim të  
Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”<sup>2</sup>**

Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës dhe Nenit 56 të Ligjit nr \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ “Për Lejet e Mjedisit”,

**URDHEROJ:**

1. Ministria, për përgatitjen e raporteve për Lejet e Mjedisit të Tipit A, në zbatim të Ligjit Nr \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ “Për Lejet e Mjedisit” të përdorë pyetësorin në Aneksin I të këtij Urdhri.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

**FATMIR MEDIU**

---

<sup>2</sup> Ky urdhër transponon Vendimin e Komisionit 2006/194/EC Hartimi i pyetësorit në lidhje me Direktivën 96/61/EC përsa i përket parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes.

## **Aneksi I. Pyetësi për zbatimin e Ligjit “Për Lejet e Mjedisit” lidhur me Lejet e Mjedisit të Tipit A**

### **Pyetësi Pjesa 1**

1. Përshkrim i përgjithshëm
  - a. Përshkruani ndryshimet që janë bërë nga Ligji i ri “Për Lejet e Mjedisit” dhe në veçanti, përshkruani dhe shpjegoni regjimin e ri për Lejet e Mjedisit të Tipit A.
  - b. Përshkruani të gjitha vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të Ligjit në lidhje me Lejet e Mjedisit të Tipit A lidhur me disponibilitetin dhe kapacitetin e stafit. Përshkruani planet që keni për të zgjidhur këto vështirësi (psh përmes rritjes së numrit të stafit).
2. Numri i instalimeve dhe lejeve të mjedisit të Tipit A
  - a. Jepni hollësi për numrin e instalimeve ‘të reja’ dhe ‘ekzistuese’ (siç përcaktohen nga Ligji) dhe Lejet e Mjedisit të Tipit A sipas llojit të aktivitetit.
  - b. Përdorni modelin dhe shënimet e specifikuar në Pjesën 2 të këtij Aneksi.
3. Instalimet ekzistuese
  - a. Përshkruani të gjitha aktet ose planet administrative të hartuara për të siguruar respektimin e kërkesave të Ligjit pas tetë vjetësh nga hyrja në fuqi e Ligjit.
  - b. A janë operatorët të detyruar të dorëzojnë ose a munden autoritetet të kërkojnë nga operatorët dorëzimin e aplikimeve për leje për këtë qëllim?
4. Aplikimet për leje mjedisi të Tipit A
  - a. Përshkruani (ose në mënyrë të përgjithëshme ose për çështje specifike, p.sh. për metodologjinë për vlerësimin e shkarkimeve të mëdha nga instalimet) të gjitha rregullat e përgjithshme detyruese, dokumentat udhëzuese apo format e aplikimit të miratuara që sigurojnë që aplikimet të përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar në bazë të Nenit 11 të Ligjit.
5. Koordinimi i procedurës dhe kushteve të dhënies së lejeve të Tipit A
  - a. Përshkruani strukturën organizative të procedurës së dhënies së lejeve, sidomos çdo ndryshim që është prezantuar nga Ligji i ri (nivelet e autoriteteve, shpërndarjen e kompetencave, etj.).
  - b. A ekzistojnë vështirësi të veçanta për sigurimin e koordinimit të plotë të kushteve dhe procedurës së dhënies së lejeve, sidomos në rastet kur përfshihet më shumë se një autoritet kompetent? Përshkruani të gjitha aktet apo dokumentat udhëzuese të miratuara për këtë çështje.
  - c. Cilat dispozita ligjore, procedura apo udhëzues janë përdorur për të siguruar që autoritetet kompetente refuzojnë të japin një leje në rast se instalimi nuk respekton kërkesat e këtij Ligji? Nqse është mundur, jepni informacion për numrin e lejeve të refuzuara dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur një gjë e tillë.

6. Përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria e kushteve të lejes
  - a. Përshkruani të gjitha rregullat e përgjithshme detyruese ose udhëzimet specifike për autoritetet kompetente që janë miratuar për çështjet e mëposhtme:
    - i. Proçedurat dhe kriteret për përcaktimin e vlerave kufi të shkarkimeve dhe kushteve të tjera të lejes.
    - ii. Parimet e përgjithshme për përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme.
    - iii. Zbatimin e Nenit 10 (1)(d) dhe (e) të Ligjit.
  - b. Çështjet e lidhura me Dokumentat Referencë BAT (BREFs) të publikuara nga Komisioni:
    - i. Në terma të përgjithshme, si është marrë në konsideratë, në përgjithësi apo në raste të veçanta, informacioni i publikuar nga Komisioni në mbështetje të Nenit 16(2) të Direktivës IPPC (2008/1/EC) kur përcaktohen teknikat më të mira të disponueshme?
    - ii. Si janë përdorur konkretisht BREFs për përcaktimin e kushteve të lejes?
    - iii. A janë përkthyer në shqip BREFs (apo një pjesë e tyre)?
    - iv. Sa i dobishëm është informacioni i publikuar nga Komisioni mbështetur në Nenin 16(2) të Direktivës KPIN për përcaktimin e vlerave kufi të shkarkimeve, parametrave ekuivalentë dhe masave teknike bazuar në teknikat më të mira të disponueshme? Si mund të përmirësohet ai?
  - c. Çështje të tjera lidhur me kushtet e lejes:
    - i. Në përcaktimin e kushteve të lejes a janë marrë në konsideratë sistemet e menaxhimit të mjedisit? Nëse po, si?
    - ii. Çfarë lloj kushtesh për leje apo masash të tjera janë aplikuar posacërisht për qëllimet e Nenit 9(1)(g) të Ligjit (rehabilitimi i territorit pas mbylljes përfundimtare të aktiviteteve) dhe si janë zbatuar ato në praktikë?
    - iii. Çfarë lloj kushtesh për leje janë vendosur posacërisht lidhur me efikasitetin e energjisë (Neni 9(1)(d))? Si është përdorur mundësia e zgjedhjes që jep Neni 10(3) për të mos imponuar kërkesat lidhur me efikasitetin e energjisë?
7. Të dhëna përfaqësuese të disponueshme
  - a. Jepni të dhënat përfaqësuese që disponohen për vlerat kufi dhe performancën mjedisore të parashtruar sipas kategorive specifike të aktiviteteve në përputhje me Aneksin I të këtij Ligji dhe, sipas rastit, teknikat më të mira të disponueshme nga të cilat rrjedhin këto vlera.
  - b. Përshkruani se si këto të dhëna janë zgjedhur dhe mbledhur.
8. Normat e cilësisë së mjedisit
  - a. A ka patur raste për të cilat aplikohet Neni 10(1)(g) dhe përdorimi i teknikave më të mira të mundshme ka qenë i pamjaftueshëm për të kënaqur normën e cilësisë së mjedisit të përcaktuar me akte të tjera?

- b. Nëse po, jepni shembuj të rasteve të tilla dhe masave shtesë që janë marrë.

9. Zhvillimet në teknikat më të mira të disponueshme

- a. A janë marrë hapa për të siguruar që, në përputhje me Nenin 7, autoritetet kompetente ndjekin apo janë të informuara për zhvillimet në teknikat më të mira të disponueshme?
- b. Nëse po, jepni hollësi.
- c. Nëse jo, përshkruani planet që synojnë të përmbushin këtë kërkesë?

10. Ndryshimet në instalime

- a. Në praktikë, sipas Nenit 16 të Ligjit, si e përcaktojnë autoritetet kompetente nëse një 'ndryshim në operim' mund të ketë pasoja mbi mjedisin, dhe sipas Neni 17 të Ligjit, nëse një ndryshim i tillë është 'ndryshim thelbësor' nëse ai mund të ketë efekte negative të konsiderueshme mbi njerëzit apo mjedisin? Jepni referenca për dispozitat ligjore, udhëzuesit apo procedurat përkatëse.

11. Ri-shqyrtimi dhe përditësimi i kushteve të lejeve

- a. Përshkruani shpeshhtësinë e ri-shqyrtimit dhe, sipas rastit, të përditësimit të kushteve të lejes (Neni 18). Jepni referenca për aktet, udhëzuesit apo procedurat përkatëse.
- b. Cila është shpeshhtësia përfaqësuese (ose shpeshhtësia përfaqësuese e pritshme) e ri-shqyrtimit të kushteve të lejes? Në rastet e ndryshimeve ndërmjet instalimeve apo sektorëve, jepni informacion ilustrues nëse është i disponueshëm.
- c. Ku konsiston procesi i ri-shqyrtimit dhe përditësimit të kushteve të lejes? Si zbatohet dispozita për ri-shqyrtimin e kushteve të lejes në rastet e ndryshimeve thelbësore në teknikat më të mira të disponueshme që janë duke u zbatuar? Jepni referenca për aktet ligjore, udhëzuesit apo procedurat përkatëse.

12. Respektimi i kushteve të lejes

- a. Si është zbatuar në praktikë kërkesa e Nenit 10(2)(k) dhe (I) që operatorët informojnë rregullisht autoritetet për rezultatet e vetë-monitorimit të shkarkimeve? Jepni referenca për të gjitha rregulloret specifike, procedurat apo udhëzimet për autoritetet kompetente në këtë çështje.
- b. A e kanë dorëzuar operatorët raportin periodik të vetë-monitorimit? Jepni informacion për shpeshhtësinë përfaqësuese për dorëzimin e këtij informacioni. Në rastet e ndryshimeve midis sektorëve, jepni informacion nëse është i disponueshëm.
- c. Aq sa është e mundur, jepni informacion përfaqësues, në lidhje me instalimet që kërkojnë leje mjedisi të Tipit A, për çështjet e mëposhtme:
  - i. kryerja e inspektimeve në terren dhe marrja e kampionëve (lloji, numri, shpeshhtësia),
  - ii. llojet dhe numrat e veprimeve (p.sh. sanksionet apo masat e tjera) të ndërmarra si rezultat i aksidenteve, incidenteve dhe mos respektimit të kushteve të lejes.

13. Informimi dhe pjesëmarrja e publikut:

- a. Përshkruani se si Ligji dhe akte të tjera sigurojnë informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në procedurën e lejes së mjedisit të Tipit A.
- b. Cili ka qenë efekti mbi autoritetet kompetente, kërkesit e lejes dhe publikun lidhur me këto kërkesa?

14. Bashkëpunimi ndërkufitar

- a. A ka patur raste të përdorimit të kërkesave të Neneve 43 dhe 44 përsa i përket bashkëpunimit dhe informacionit ndërkufitar?
- b. Jepni shembuj ilustrativë të procedurave të përgjithshme të përdorura.

15. Lidhja me aktet e tjera ligjore

- a. Cila është efektiviteti i këtij Ligji, përsa i përket lejeve të mjedisit të tipit A, në krahasim me aktet e tjera?
- b. Bazuar në studimet apo analizat përkatëse, nëse është e mundur, cilat kanë qenë kostot dhe përfitimet mjedisore (përfshirë kostot administrative dhe ato të përputhshmërisë) nga zbatimi i Ligjit lidhur me lejet e mjedisit të tipit A? Jepni referenca për këto studime dhe analiza.
- c. Cila është eksperiencia praktike në lidhje me ballafaqimin e kërkesave për dhënien e lejes së mjedisit të Tipit A sipas këtij Ligji dhe akteve të tjera të zbatueshme për instalimet që janë subjekt i regjimit të lejeve të Tipit A? Përshkruani aktet ligjore dhe rregullimet administrative në fuqi që synojnë rritjen e koherencës midis zbatimit të këtij Ligji dhe akteve të tjera. Këto akte mund të përfshijnë:
  - i. Ligjin “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
  - ii. Ligjin “Mbi Kontrollin e Rreziqeve për Aksidente të Mëdha Industriale që shkaktohen nga substance kimike”;
  - iii. Legjislacionin për kufizimin e shkarkimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme në sajë të përdorimit të tretësve organikë në aktivitete dhe instalime të caktuara;
  - iv. Vendimin e Këshillit të Ministrave “Mbi Lendfillin e Mbetjeve”
  - v. Ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave”;
  - vi. Vendimin e Këshillit të Ministrave “Mbi Incinerimin e Mbetjeve”;
  - vii. Pjesën 2, Kreu 4 të këtij Ligji për impiantet e mëdha me djegies;
  - viii. Legjislacionin për skemën e tregtimit të shkarkimeve të lejuara të gazrave serrë;
  - ix. Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e Regjistrimit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve”.
- d. Përshkruani masat që janë prezantuar për të kanalizuar raportimin që autoritetet kompetente kërkojnë nga operatorët e instalimeve apo instrumentave të tjerë të Tipit A. Nqse disponohen, jepni referenca për masa të tilla dhe të gjitha mundësitë që shihni për përmirësimin e kërkesave në këtë fushë.

16. Konsiderata të përgjithshme

a. A ka ndonjë problem me zbatimin e Ligjit? Nqse po, specifikojini.

## Pjesa 2. Modeli për përgjigjen e pyetjes 2.b

**Tabela 1**

Lloji i Instalimit Tipit A <sup>(1)</sup>	Lejet për instalimet e reja		Lejet për instalimet ekzistuese					8. Nr i instalimeve (1+3)	9. Nr i caktuar për aplikime për 'ndryshime thelbësore' <sup>(6)</sup>
	1. Nr i instalimeve të reja operuese <sup>(2)</sup>	2. Nr i lejeve të mjedisit të Tipit A të dhëna <sup>(3)</sup>	3. Nr i instalimeve ekzistuese operuese <sup>(2)</sup>	4. Nr i lejeve të reja të mjedisit të Tipit A të dhëna <sup>(4a)</sup>	5. Nr i lejeve të para-Tipit A të ri-shqyrtuara, por jo të përditësuara <sup>(4b)</sup>	6. Nr i lejeve të para-Tipit A të ri-shqyrtuara, dhe të përditësuara <sup>(4c)</sup>	7. Nr, nëse ka, i lejeve pezull (në konflikt me këtë Ligj) <sup>(5)</sup>		
<b>1. Energjia</b>									
1.1. Instalimet me djegie									
1.2. Rafinimi i vajrave dhe gazit natyror									
1.3. Furrat e koksit									
1.4. Gazifikimi dhe lëngëzimi i qymyrgurit									
1.5. Nxjerrja e naftës bruto dhe e gazit natyror									
<b>2. Metalet</b>									
2.1. Pjekja/Sinterimi i xeherorëve të metaleve									
2.2. Prodhimi i gizës ose çelikut									
2.3 (a) Fabrikat e									



petëzimit në të nxehtë										
2.3 (b) Farkëtaritë										
2.3 (c) Aplikimi i veshjeve metalike										
2.4. Fonderitë										
2.5 (a) Prodhimi i metaleve jo-ferorë të papërpunuar										
2.5 (b) Shkrirja e metaleve me ngjyra										
2.6. Trajtimi sipërfaqësor i metaleve dhe plastikave										
<b>3. Minerale</b>										
3.1. Prodhimi i çimentos ose gëlqeres										
3.2. Prodhimi i asbestit										
3.3. Prodhimi i qelqit										
3.4. Shkrirja e mineraleve										
3.5.(a) Prodhimi i qeramikës										
<b>4. Kimikatet <sup>(7)</sup></b>										
4.1. Prodhimi i kimikateve organike										
4.2. Prodhimi i kimikateve inorganike										
4.3. Prodhimi i plehrave										

4.4. Prodhimi i produkteve për shëndetin e bimëve/Biocidet										
4.5. Prodhimi i farmaceutikëve										
4.6. Prodhimi i eksplozivëve										
<b>5. Mbetjet</b>										
5.1. Asgjesimi ose rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme										
5.2. Incinerimi i mbetjeve bashkiake										
5.3. Asgjesimi i mbetjeve jo-të rrezikshme										
5.4. Lendfillet										
<b>Të tjera</b>										
7.1 (a) Prodhimi i brumit të letrës										
7.1 (b) Prodhimi i letrës dhe kartonit										
7.4. Paratrajtimi ose ngjyrosja e fibrave ose tekstileve										
7.6.a. Regjja e gëzofëve dhe lëkurave										
7.7 (a) Thertoret										
7.7(c) Trajtimi dhe përpunimi i produkteve ushqimore										
7.7(e) Trajtimi										

dhe përpunimi i qumështit										
7.7 (b) Asgjesimi ose riciklimi i kufomave të kafshëve										
7.8 (a) Rritja intensive e pulave										
7.8 (b) Rritja intensive e derrave për riprodhim										
7.8 (c) Rritja intensive e dosave										
7.9. Trajtimi sipërfaqësor me përdorimin e tretësve organikë										
7.2. Prodhimi i karbonit ose elektrografitit										
12.2 Kapja e rrymave të CO2										
<b>Totali</b>										

**Tabela 2**

	<b>Totali</b> <sup>(8)</sup>
Numri total i lejeve që konsiderohen në përputhshmëri me Ligjin (Tabela 1 kolonat 2+4+5+6)	
Numri total, nëqse ka, i lejeve pezull (në konflikt me Ligjin) (Tabela 1 kolona 7)	

Shënime për Tabelat:

Shënim i përgjithshëm: Ky model (shabllon) përdoret për grumbullimin e të dhënave për numrin e ‘instalimeve’ të Tipit A dhe ‘lejet e mjedisit të Tipit A’ siç përcaktohen në Nenin 3(1) të Ligjit. Numri i instalimeve dhe numri i lejeve nuk do të jenë domosdoshmërisht identikë pasi, sipas Nenit 8(2), një leje mund të mbulojë pjesë të një instalimi, të gjithë instalimin apo më shumë se një instalim. Udhëzime dhe shpjegime të mëtejshme në lidhje me të dhënat e kërkuara në Tabelat 1 dhe 2 janë dhënë në shënimet 1-9 më poshtë. Numri i lejeve duhet të përfshijë të gjitha lejet e lëshuara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit “Për Lejet e Mjedisit” për instalimet që janë ende në operim.

1. Për të gjitha kolonat 1-10, Tabela 1 ofron një model për grumbullimin e të dhënave bazuar në aktivitetin kryesor të instalimit të Tipit A, Aneksi I. Nqse është e mundur, informacioni duhet ofruar në nivelin e nëntitujve të Aneksit I (1.1, 2.3(a), 6.4(b), etj.). Për këtë arsye kolona e majtë përcakton numrat e nëntitujve përkatës të Aneksit I dhe përmbledhjen e shkurtuar të përshkrimeve të aktivitetit korrespondues (shih Aneksin I të Ligjit për përshkrimet e plota përfshirë pragjet). Gjatë plotësimit të Tabelës 1, duhet treguar kujdes për të mos numëruar më shumë se një herë të njëjtin instalim ose leje, edhe nëse instalimi apo leja mbulon disa aktivitete. Kur instalimi ose leja e mjedisit të Tipit A përfshin aktivitete që bëjnë pjesë në dy ose më shumë kategori të Tipit A, Aneksi I, instalimi apo leja duhet listuar vetëm në një kategori të Tipit A, Aneksi I (p.sh. në atë që përshkruan më mirë instalimin ose lejen).
2. Kolonat 1 dhe 3 kërkojnë një numërim të thjeshtë të instalimeve të reja dhe ekzistuese, për secilin lloj aktiviteti të Tipit A, Aneksi I, që janë në funksionim në fund të periudhës raportuese. ‘Instalimet ekzistuese’ janë ato ato të përcaktuara sipas Nenit 3(1) të Ligjit, dhe ‘instalimet e reja’ janë gjithë të tjerat. Kolona 8 më tej thjesht përfaqëson shumën e shifrave në kolonat 1 dhe 3.
3. Kolona 2 kërkon të dhëna për numrin e lejeve të mjedisit të Tipit A të dhëna për instalimet e reja në përputhje me fundin e periudhës raportuese. Siç vihet re në shënimin e përgjithshëm më sipër, ky numër nuk do të jetë domosdoshmërisht i njëjtë me numrin e instalimeve, edhe nëqse të gjitha instalimet e reja kanë marrë leje të plota.
4. Kolonat 4-6 trajtojnë mënyrat e ndryshme si si instalimet ekzistuese mund të bëhen subjekt i lejeve të mjedisit të Tipit A që konsiderohen në përputhshmëri me Ligjin. Këto janë si më poshtë:

- a. dhënia e lejes së mjedisit të Tipit A. Kolona 4 i referohet një leje të tillë si leje e re. Shifrat përfshijnë çdo lloj leje të tillë të re të dhënë si pasojë e ‘ndryshimit thelbësor’ të propozuar.
  - b. si alternativë për aplikimin e procedurës së përcaktuar në pikën (a) më sipër, Neni 53 lejon një autoritet kompetent të sjellë në përputhshmëri instalimet ekzistuese ‘duke ri-shqyrtuar dhe, kur është e nevojshme, duke përditësuar’ kushtet ndaj të cilave instalimet janë tashmë subjekt, p.sh.nën atë çka mund të quhet leje para-IPPC (që do të thotë leje e lëshuar sipas legjislacionit që paraprin zbatimin e Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”). Kolona 5 kërkon të dhëna për ato raste kur kushtet e një leje të tillë para-IPPC janë ri-shqyrtuar, por nuk janë përditësuar pasi është gjykuar se ato kushte i plotësojnë kërkesat e Ligjit.
  - c. kolona 6 në mënyrë të ngjashme kërkon të dhëna për ato raste kur kushtet e një leje para-IPPC janë ri-shqyrtuar dhe rrjedhimisht kushtet janë përditësuar me qëllim që të respektojnë Ligjin. Këtu përfshihen të gjitha lejet për të cilat ri-shqyrtimi dhe përditësimi kanë ardhur si pasojë e ‘ndryshimit thelbësor’ të propozuar.
5. Kolona 7 kërkon të dhëna për të gjitha lejet për instalimet ekzistuese që, në fund të periudhës raportuese, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit, mbeten ende për tu dhënë, ri-shqyrtuar apo përditësuar, deri sipas rastit.. Tregoni se si i trajtojnë autoritetet kompetente kërkesat për leje të tilla që vonohejnë të jepen.
  6. Kolona 9 kërkon të dhëna për numrin e kërkesave për leje (ose përditësimin e lejeve) nga operatorët e instalimeve ekzistuese apo të reja përsa i përket ‘ndryshimit thelbësor’ të propozuar të vendosur gjatë periudhës raportuese. Këtu përfshihen ndryshimet thelbësore në instalimet që tashmë janë bërë subjekt i përputhshmërisë me Ligjin.
  7. Megjithëse informacioni përgjithësisht raportohet nga llojet e aktivitetit kryesor të listuar në Tabelën 1 në atë masë që është e mundshme, dihet që sektori kimik është veçanërisht kompleks në këtë drejtim dhe që shumë instalime kimike kryejnë më shumë se një aktivitet, siç përcaktohet në nëntitujt e Titullit 4. Për këtë arsye raporti duhet të përmbajë informacion sipas nëntitujve nëse disponohen të dhëna, përndryshe të raportohen vetëm shifrat e plota për Titullin 4 (që do të thotë jo shifra për nëntitujt e vecantë).
  8. Tabela 2 kërkon numrin total të lejeve që në fund të periudhës raportuese konsiderohen se janë në përputhje me Ligjin apo që janë lënë pezull. Rreshti i parë përfaqëson shumën e totaleve të kolonave 2, 4, 5 dhe 6 të Tabelës 1. Rreshti i dytë përfaqëson totalin e kolonës 7 të Tabelës 1.